



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/61

Datë: 22.08.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 gusht 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Edukimin Parashkollor - Edukimin në Fëmijërinë e Hershme 0 - 6 vjeç.
2. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



KONCEPTDOKUMENT
PËR EDUKIMIN NË FËMIJËRINË E HERSHME 0-6 VJEÇ

Gusht, 2018

Kapitulli 1

Hyrje

Zhvillimi në fëmijërinë e hershme është duke bërë paraqitje të fuqishme në shkallë botërore pasi që paradigma e zhvillimit kombëtar, ekonomik dhe shoqëror është duke kaluar nga progresi i pastër ekonomik në mirëqenien njerëzore¹. Njësoj për shtetet me të ardhura të ulëta, të mesme dhe të larta, investimi në formimin e kapitalit njerëzor është bërë pjesë e pandashme e strategjive kombëtare.² Si rrjedhojë, janë krijuar tri fusha të pavarura të njohurisë, që janë neuro-shkenca, ekonomia dhe shkenca për vlerësim të programit, që investojnë në vitet e hershme duke i kushtuar një ndarje të lartë formimit të kapitalit njerëzor. Këto tri fusha rrjedhin drejtë një përfundimi: zhvillimi i hershëm njerëzor është i pandashëm për zhvillimin e përgjithshëm.³ Zhvillimi i Fëmijërisë së Hershme është koncept shumëdimensional që mbulon periudhën e fëmijërisë së hershme prej paralindjes gjer në moshën 8 apo 9 vjeçare apo gjersa të përfundojë tranzicioni i hyrjes në shkollë.

Në Kosovë sistemi i edukimit parashkollor – edukimi në fëmijërinë e hershme është i rregulluar me Ligjin nr. 02/L-52 mbi edukimin parashkollor i miratuar në vitin 2006. Sistemi për edukimin parashkollor preket edhe me akte tjera ligjore dhe nënligjore. Si ligji për edukim parashkollor ashtu edhe aktet tjera, në momentin e hartimit dhe për një periudhë të caktuar kohore, duke marrë parasysh kontekstin e përgjithshëm të zhvillimit institucional në Kosovë, kanë siguruar bazë të mjaftueshme për të themeluar sistemin e nivelit parashkollor të edukimit. Por, me kalimin e kohës me gjithë përpjekjet konsiderohet se progresi ka qenë i kufizuar si në aspektin gjithëpërfshirës ashtu edhe në aspektin e sigurimit të cilësisë së shërbimeve për edukimin parashkollor – edukimin në fëmijërinë e hershme.

Nevoja për të kaluar në një fazë të re të zhvillimit dhe për ndryshimin e qasjes në edukim parashkollor është pasqyruar edhe në vazhdimësi në raportet e Progresit të Komisionit Evropian, ndërsa synimet për një qasje të tillë janë vendosur në dokumentet kryesorë strategjike, planifikuese dhe të politikave në nivel të Qeverisë konkretisht në sektorin e arsimit. Nevoja për ndryshim të politikave për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç është shprehur në Programin e Qeverisë 2014-2018, në Promemorien 2016-2018 për sektorin e arsimit, Planin e punës së Qeverisë dhe MASHT-it për vitin 2018 si dhe në nga tetë rekomandimet të cilat e mbështesin zhvillimin e fëmijërisë së hershme, të cilat janë miratuar në kuvendin e Republikës së Kosovës në vitin 2012.

Përveç kësaj, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, në mbështetje të këtyre dokumenteve si prioritet themelor e trajton rregullimin juridik të fushës së edukimit në fëmijërinë e hershme në Republikën e Kosovës, si instrument shumë i rëndësishëm i rregullimit të sferës së edukimit në fëmijërinë e hershme në vendin tonë, si dhe duke analizuar studimet e fundit në këtë fushë zhvillimi, përvojat më të mira të vendeve të rajonit në drejtim të ngritjes dhe zhvillimit të edukimit, rrjedhimisht dinamikës së reformave në arsim.

Prandaj, ky konceptdokument si në vijim përcakton politikat kryesore të cilat ligji i ardhshëm duhet të

Britto, P., & Ravens., J., & Ponguta, L., (2011): Dora Dorës Universiteti "Yale" Qendra "Edward Zigler" për zhvillimin e fëmijës dhe politikave sociale.,¹ (Alderman & King, 2006) fq 7

² (Mankiw, Romer, & Weil, 1992). fq 7

³ (Heckman & Kruger, 2003; McCartney & Phillips, 2006; Shonkoff & Phillips, 2000). fq 7.

qendrat e komunitetit dhe kush është përgjegjës për hapjen e formave alternative të edukimit të hershëm.

6. Ushqimi i shëndetshëm i fëmijëve – ligji nuk përcakton përgjegjësitë për krijimin e menysë dhe ofrimin e ushqimit të shëndetshëm për moshat e fëmijëve, i cili na siguron një mirëritje dhe zhvillim të fëmijëve.

7. Si dhe aspekte tjera të cilat janë përshkruar në opsionin e dytë për t'u rregulluar me ligjin e ri. Prandaj, pas konsultimeve të shumta do të kujdesemi që kjo fushë të rregullohet në përputhje të plotë me standardet e zhvillimit të fëmijëve dhe me standardet ndërkombëtare të zhvillimit të fëmijëve në moshën e hershme.

1. Tabela e përmasave dhe kohëzgjatja e zotimit është si në vijim:

Nëse institucionet e Republikës së Kosovës nuk ndërmarrin masat e duhura për adresimin e sfidave të identifikuar dhe përmendura më lartë me këtë konceptdokument atëherë përmasat dhe probabiliteti i përmasave të zgjatjes së problemit do të jenë si në vijim:

Tabela e përmasave dhe kohëzgjatjes së problemit dhe zotimit					
	Viti 2017/ 2018	Viti 2018/ 2019	Viti 2019/ 2020	Viti 2020/ 2021	Viti 2021/ 2022
Fëmijë të moshës 0<5 vjeç					
Numri i fëmijëve të përfshirë në institucionet e edukimit parashkollor	6 636 fëmijë të përfshirë	1100 fëmijë të rinj	200 fëmijë të rinj	200 fëmijë të rinj	200 fëmijë të rinj
% e fëmijëve që do të mbesin jashtë institucioneve parashkollore	95,1%	94.3%	94%	93.8%	93.5%
Fëmijët e moshës 5<6 vjeç					
% e fëmijëve mbesin jashtë klasës para-filllore	7.6%	2%	1%		

Tabela nr.1

Politika aktuale

Dokumentet strategjike dhe të politikave - Kjo fushë është e rregulluar me Ligjin për Edukimin Parashkollor i hartuar në vitin 2006. Instrumenti kryesor për të arritur qëllimet e përcaktuara në këtë ligj është Plani strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, Plani kombëtar për arsim i Qeverisë së Kosovës, strategjitë e ministrive të linjës, plani i punës së Divizionit për Edukim Parashkollor si dhe implementimi i projekteve të partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë të cilët punojnë në këtë nivel edukimi.

Objektivi kryesor për edukimin parashkollor sipas PSAK-ut është:

Të gjithë fëmijët e moshës 5 vjeçare të përfshihen në edukimin cilësor parafillor. Rritja e përfshirjes në edukimin parashkollor cilësor të fëmijëve të moshës 0-5 vjet;

Hartimi dhe zbatimi i programit për aftësimin e edukatoreve në shërbim që punojnë me fëmijët 0-3. Zhvillimi i programeve për vetëdijësimin e prindërve lidhur me fëmijërinë e hershme; organizimi i aktiviteteve për vetëdijësimin e shoqërisë për rëndësinë e investimit në edukimin parashkollor; Pilotimi i kurrikulës bërthamë për edukim parashkollor; Aftësimi i edukatoreve për zbatimin e kurrikulës së re; Hartimi i materialeve mësimore dhe didaktike të posaçme për klasën parafillore; Stimulimi i hapjes dhe licencimit të institucioneve private dhe qendrave me bazë komunitetin; krijimi i një rrjeti të dadove të aftësuara dhe të kontrolluara.

Informatat për zbatimin e këtyre caqeve dhe politikave për këtë fushë janë dhënë më lartë tek analiza e situatës.

Megjithatë, në nivel të përgjithshëm qeveritar, niveli i edukimit parashkollor-edukimi në fëmijërinë e hershme, nuk ka qenë asnjëherë prioritet i edukimit, e as njëri nga prioritetet në arsim.

Legjislacioni

Niveli i edukimit parashkollor rregullohet me legjislacionin si në vijim:

1. Ligji për edukimin parashkollor
2. Ligji për arsimin në komuna
3. Ligji për arsimin parauniversitar
4. Ligji për vetëqeverisjen lokale
5. 22 Udhëzime administrative të miratuara nga ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Programi aktual

- Programi i Qeverisë 2015-2018 parasheh që *“ndërtimi dhe funksionalizimi i Programit Kombëtar për Zhvillim gjatë Fëmijërisë së Hershme, i cili do të ofrojë shërbime dhe vizita të rregullta të mjekëve në familjet e fëmijëve të moshës 0-3 vjet, sigurimi i hapësirave të mjaftueshme, si adaptimi i shtëpive ekzistuese nëpër fshatra apo lagje, për arsimin parashkollor për fëmijët e moshës 3-6, si dhe trajnimi dhe punësimi i një numri të konsiderueshëm të edukatoreve, janë ndër pikat kyçe të Programit të Qeverisë për fushën e Arsimit.*
- Programi i Qeverisë, gjithashtu parasheh angazhimin *“për rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor nëpërmjet skemave publiko-private për stimulimin e ndërtimit të objekteve të kopshteve për fëmijë dhe përkrahjen e institucioneve private të edukimit parashkollor. Në këtë kuadër, Qeveria e Republikës së Kosovës do të angazhohet për hapjen e paraleleve parafillore në të gjitha shkollat filllore të Kosovës për fëmijët e moshës 5-6 vjeç, në mënyrë që të zvogëlohet ngarkesa në institucionet parashkollore. Ngritja e vetëdijes në nivelin e përgjithshëm për investim në fëmijërinë e hershme dhe fuqizimi i bashkëveprimit ndër-sektorial”.*

Plani i punës së MASHT për vitin 2018 :

1. Finalizimi dhe pilotimi i Kurrikulës Bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme 0-5 vjeç.

Niveli i edukimit parashkollor që nga viti 2006 është rregulluar dhe funksionon sipas dispozitave të përcaktuara me ligjin për edukim parashkollor dhe ligjet e përmendura më lartë. Është konstatuar se ky ligj nuk i ka krijuar kushtet e mjaftueshme për të përkufizuar më qartë kategoritë e fëmijëve me të cilët Qeveria do të jetë përgjegjëse të ofrojë shërbimet për edukim në nivel parashkollor. As ligji dhe as korniza tjetër ligjore në shumë segmente nuk ka sqaruar kompetencat qoftë mes nivelit qendror të qeverisë (MASHT) dhe nivelit komunal, qoftë mes institucioneve të ndryshme në nivelin qendror (shih në kapitullin për problemet).

Një situatë e tillë ka shkaktuar një shkallë të ulët të rritjes së përfshirjes së fëmijëve dhe mungesë të kualitetit në ofrimin e shërbimeve për fëmijët në nivelin parashkollor privat, dhe qëndrueshmërinë e qendrave të komunitetit.

Sipas studimit të fundit të dalë nga raporti i MICS– UNICEF, përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muajsh që vijnë ndonjë program të arsimit parashkollor është 13.9, ndërsa vetëm 33.1 e fëmijëve të moshës nën 5 vjeç, kanë tri ose më shumë libra për fëmijë.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Sipas vlerësimeve të paraqitura më lartë, një nga faktorët e një situatë jo të kënaqshme në ofrimin e shërbimeve të edukimit për fëmijët në nivelin parashkollor është politika dhe legjislativi i papërshtatur me trendet e reja të zhvillimit në këtë fushë.

Prandaj, ndryshimi i politikës aktuale do të bëhet duke hartuar dhe miratuar ligj të ri për sistemin e edukimit parashkollor, të quajtur (Ligji për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme) dhe me këtë rast duke zëvendësuar ligjin e vitit 2006, duke plotësuar zbrazëtitrat ligjore dhe eliminuar kolizionin ekzistues ligjor me të cilin do të rregullohet e tërë veprimtaria e edukimit në fëmijërinë e hershme.

1. Përshkrimi i SNKA 0 (**Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit**) - Aspektet multi-dimensionale të ZHFH-së, përbëhen nga disa domene të rritjes, mësimnxënies dhe zhvillimit, përfshirë shëndetin fizik dhe motorik, aftësitë njohëse, zhvillimin shoqëror, etik, shpirtëror dhe emocional, aftësitë gjuhësore dhe ndjenjën e identitetit kombëtar.
2. Gjithëpërfshirja, (fëmijët me nevoja të veçanta, aspektet gjinore, të drejtat e fëmijëve) – do të përcaktohen në ligjin e ri ofrimi i shërbimeve për fëmijët me nevoja të veçanta, se si do t'i qaset zhvillimi i edukimit të hershëm në aspektin gjinor, si dhe të përshkruaj qartë aspektet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve.
3. Format e organizimit (institucionet parashkollore publike, private, qendrat me bazë në komunitet, partneritetin publiko privat, format alternative). – do të përcaktohen qartë në ligjin e ri, organizimi i të gjitha formave të edukimit parashkollor, përgjegjësitë monitorimi etj.
4. Me Ligjin e ri, do të sqarohet koordinimi ndërsektorial ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shëndetësisë, Mirëqenies Sociale dhe Financave. Pritet që në ligjin e ri të kemi shembuj konkret të koordinimit ndërsektorial, të shërbimeve ekzistuese për fëmijët e moshës 0-6 vjeç.
5. Pjesëmarrja e familjes në ligjin e ri do të përfshijë tri elemente kryesore : Parimet e angazhimit të familjes, familja efikase strategji angazhimi, dhe ndërtimi i kurrikulës programeve të punës edukative.
6. Staf i menaxherial, edukativ dhe teknik i institucionit parashkollor – do të rregullohet me këtë ligj: menaxhimi i institucionit edukativ, kush mund ta bëjë atë, kush mund të jetë stafi edukativ sipas grup-moshave të fëmijëve, do të përcaktojë edhe detyrat e stafit teknik si pjesë e institucionit parashkollor.

7. Ushqimi i shëndetshëm i fëmijëve – ligji do të përcaktojë përgjegjësitë për krijimin e menysë dhe ofrimin e ushqimit të shëndetshëm për moshat e fëmijëve.
8. Kurrikula - ligji i ri do të përshkruaj se çfarë është një program kurrikular, si lidhen programet kurrikulare me llojet e ndryshme të metodave të të nxënës, si dhe si ndërlikohet kurrikula me standardet e zhvillimit.
9. Dokumentacioni pedagogjik - ligji i ri do të definojë çfarë është dokumentacioni pedagogjik, kush është përgjegjës për hartimin/plotësimin e dokumentacionit pedagogjik për edukimin parashkollor dhe cilat janë ato.
10. Materiali didaktik - do të përcaktojë qartë përdorimin dhe sigurimin e materialit didaktik në institucionet parashkollore dhe në ambientet e familjes duke u mbështetur në moshën e fëmijëve.
11. Tekstet edukative, në ligjin e ri, do të përcaktohet siguri, përmbajtja, përdorimi si dhe ndërlikohet me përmbajtjen dhe standardet e zhvillimit dhe të mësuarit.
12. Themelimi/licencimi i institucioneve parashkollore – ligji i ri duhet të adresojë përgjegjësitë për themelimin e institucioneve parashkollore publike, licencimin e institucioneve parashkollore private, kush i themelon qendrat e komunitetit dhe kush është përgjegjës për hapjen e formave alternative të edukimit të hershëm.
13. Të saktësohet funksionimi i qendrave me bazë në komunitet.
14. Mbledhja e informatave- do të përshkruhet qartë se si do të bëhet mbledhja e informatave për përfshirjen e fëmijëve të cilët marrin shërbime edukative dhe futjen e tyre në sistemin e menaxhimit të informative në MASHT.
15. Monitorimi i punës edukative dhe mirërritjes së fëmijëve, do të përcaktohet qartë se kush do ta monitorojë sistemin e edukimit parashkollor.
16. Aftësimi i dadove, për vitet e para, në mungesë të ndërtimit të mjaftueshëm të çerdheve, me këtë ligj, saktësohet krijimi dhe aftësimi i edukatoreve të cilat angazhohen nga familjet, por aftësohen nga shteti dhe mbikëqyren.
17. Ligji i ri do të përcaktojë masa të mbrojtjes dhe sigurisë së fëmijëve.
18. Ligji i ri do të harmonizohet me konventën për të drejtat e fëmijëve
19. Puna edukative që realizohet në institucionet parashkollore, do të mentorohet dhe monitorohet nga ekspertë dhe inspektorati.
20. Hartimi i ligjit të ri do të ketë për bazë manualin për vlerësimin e ndikimit të barazisë gjinore.

Opsioni 3. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Qeveria gjegjësisht MASHT, mund të vendos që të vazhdojë që nivelin e edukimit parashkollor ta zhvillojë brenda kornizës ligjore ekzistuese pa bërë ndryshime në nivel ligjor. Një qasje e tillë mund të përqendrohet në nivel të ndryshimeve dhe përmirësimeve që lejon ligji aktual.

Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Të mos intervenohet	Të hartohet ligj i ri dhe masat që ndërlidhen me zbatimin e tij.	Të ndërmerren hapa në zbatimin e ligjit ekzistues
Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni shënjestruar	Fëmijët e moshës 0-6 vjeç, stafi i institucioneve parashkollore (edukatorët)	Fëmijët e moshës 0-6 vjeç, stafi i institucioneve parashkollore (edukatorët), edukimi shëndetësia, mirëqenia sociale	Fëmijët e moshës 0-6 vjeç, stafi i institucioneve parashkollore (edukatorët)
Karakteristikat e implementimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë, sektori privat, qytetarët	MASHT, Komunitat/DKA, institucionet e arsimit parashkollor	Kuvendi, Qeveria, MASHT, Komunitat/DKA, institucionet e arsimit parashkollor, donatorët	MASHT, Komunitat/DKA, institucionet e arsimit parashkollor
Stimulimet ose mostimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat	Nuk ka ndërrime	Pritet stimulimi ekonomik, në partneritetin publiko-privat, dhe në qendrat e komunitetit	Pritet stimulimi ekonomik, në partneritetin publiko-privat, dhe në qendrat e komunitetit
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet	Ligji për arsimin parashkollor, ligji për arsimin në komuna, aktet nënligjore	Ligj i ri për Edukimin në fëmijërinë e Hershme, plotësimi me aktet nënligjore	Ligji për arsimin parashkollor, rishikimi i akteve nënligjore
Administrimi dhe ofrimi i programit ose shërbimit	MASHT/DKA, institucionet që ofrojnë shërbime edukative	MASHT/DKA, institucionet që ofrojnë shërbime edukative	MASHT/DKA, institucionet që ofrojnë shërbime edukative
Fushatat e edukimit dhe komunikimit	Nuk janë paraparë	Fushatë informative	Fushatë informative
Udhëzimet dhe kodet	Nuk janë paraparë	Rishikimi i akteve nënligjore pas miratimit të ligjit	Rishikimi i akteve nënligjore
Instrumentet tjera	n/a		
Koha	S'ka ndryshime	2018	2019

Ndryshimet aktuale konsistojnë në përmirësimet në nivel të legjislacionit sekondar/udhëzimeve administrative, ndryshimeve institucionale dhe rritje të përpjekjeve, buxhetit dhe investimeve për të përmirësuar kualitetin e shërbimeve për edukim parashkollor. Kjo mund të bëhet përmes rritjes së koordinimit mes nivelit qendror dhe lokal, ndërmarrjen e fushatave të ndryshme vetëdijesuese, edukimit etj.

Opsionet tjera

Opsionet tjera si ato:

1. Në aspektin ekonomik: tashmë është vërtetuar që përfitimet e provuara ekonomike dhe sociale të investimeve në edukimin dhe zhvillimin në fëmijërinë e hershme variojnë nga **2.50 dollarë deri në 17.07 të kursyera për çdo dollar të shpenzuar**.
2. Stimulus sepse është baza e të gjitha niveleve formale të edukimit dhe është niveli vendimtar për formimin e një individi.

Kapitulli 5. Përmbledhje e opsioneve

Nëse bëjmë një përmbledhje të opsioneve, mund të konkludojmë që nëse do të vendoset që ligji i ardhshëm për edukimin në Fëmijërinë e Hershme, do të hartohet sipas opsionit 2, mund të presim rritje të përfshirjes, rritje të cilësisë, rritje të llogaridhënies, rritje të investimeve, koordinim mes institucioneve përgjegjëse etj.

Kapitulli 6. Analiza e opsioneve - Përfitimet në tri opsionet janë:

Opsioni 1: Vazhdimi i situatës aktuale

Duke marrë parasysh trendet e zhvillimit të sistemit të nivelit të edukimit të hershëm, deri më tani, mosndërmarrja e hapave konkret për të ndryshuar kornizën ligjore, si dhe qasjen e deritashme në trajtimin e këtij niveli, gjendja pritet të mos ndryshojë. Prandaj, konsiderohet se nga ky opsion nuk mund të ketë përfitim më shumë sesa në ruajtjen e gjendjes aktuale, sepse situata e tillë nuk e lejon rritjen e përfshirjes së fëmijëve në këtë nivel të edukimit, si dhe cilësia e punës edukative mbetet e njëjtë.

Nga një gjendje e tillë pritet që pasojat do t'i prekin më së shumti fëmijët e moshës 0-6 vjeç, prindërit, familjet e tyre, zhvillimin profesional të edukatorëve të këtij niveli dhe në përgjithësi ndikon drejtpërdrejt në cilësinë në të gjitha nivelet formale të arsimit.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Ligji i ri për edukimin në fëmijërinë e hershme, i cili duhet të hartohet sipas kornizës së politikave të formuluar me këtë konceptdokument, synon që të përmirësojë situatën në nivelin e edukimit parashkollor. Sipas ligjit të ri, një qasje e re do të mundësojë zhvillimin e fëmijërisë së hershme, për të plotësuar të drejtën e edukimit për të gjithë, për të hartuar programe më të mira në këtë nivel, për të koordinuar shërbimet të cilat ofrohen për këtë nivel edukimi.

- Vitet e hershme të të nxëniet e hershëm, janë vendimtare për zhvillimin e fëmijës. Qeveria e Kosovës është e përkushtuar ndaj qëllimeve të arsimit për të gjithë, që konkretisht synojnë: “të zgjerojnë dhe të përmirësojnë përkujdesjen dhe edukimin gjithëpërfshirës në fëmijërinë e hershme, veçanërisht për fëmijët më të rrezikuar dhe për fëmijët e pafavorizuar” duke mbështetur një qasje të integruar që ngërthen procesin e edukimit, shkollimit, lojën e fëmijëve dhe përkujdesjen profesionale.
- Programi për prindër për ZHFH (zhvillimi i fëmijërisë së hershme) (prej lindjes gjer në moshën 3 vjeçare).
- ⁴Rezultatet e studimeve tregojnë se fusha kryesore e pabarazisë për fëmijët që jetojnë në varfëri është edukimi i hershëm, në veçanti te popullata rurale dhe grupet pakicë.
- Në botë janë dhënë rekomandime të fuqishme për përmirësimin e përfshirjes së prindërve në shëndetësi, arsim dhe mbrojtjen e fëmijëve.
- Rekomandohet, megjithatë, që të gjithë sektorët dhe ministritë përkatëse t’i bashkojnë forcat në përcaktimin nëse programet dhe aktivitetet ekzistuese të tyre mund të nxiten në fushën e edukimit prindëror dhe të pajtohen për një politikë të fuqishme që tejkalon kufijtë e disiplinave, siç janë mbrojtja, shëndetësia dhe edukimi.
- Përmirësimi i programeve për mësimnxënie të hershme (mosha 3 - 6 vjeçare).
- Përqendrimi vetëm në zgjerim dhe qasje në zhvillimin e fëmijërisë së hershme (ZHFH), mund të çojë në sukses të kufizuar për shkak se ofrimi i qasjes më të madhe në këto shërbime ZHFH (zhvillimi i fëmijërisë së hershme), nuk shoqërohet gjithmonë vetëm nga përmirësimi i cilësisë së shërbimeve. Hulumentimet tregojnë se cilësia e programeve është përbërësi kryesor i lidhur me përmirësimin e edukimit dhe zhvillimin e fëmijës. Në këtë rekomandim kemi paraqitur gjendjen për mësimnxënien e hershme dhe përgjigjen e kufizuar të politikave si arsytim për përmirësimin e qasjes dhe barazisë në mësimnxënien e hershme. Kjo paraqet një politikë të guximshme për të arritur rezultatet në fëmijërinë e hershme, si e drejtë dhe si parashikues të suksesit të mëvonshëm.

Shumë me rëndësi të përmendet rekomandimi që ka të bëjë me : Koordinim dhe zbatim efektiv, krijimi i sistemeve të qëndrueshme për zhvillimin e fëmijërisë së hershme (ZHFH), e cila kërkon përkrahje të infrastrukturës për të siguruar se programet dhe shërbimet koordinohen sipas nevojës dhe zbatohen me efikasitet. Me qëllim të rritjes së efektivitetit të zhvillimit të fëmijërisë së hershme, inkurajohet integrimi i buxheteve, i proceseve të planifikimit dhe zbatimit brenda dhe përgjatë ministrive, nëpërmjet një komisioni koordinues për zhvillimin e fëmijërisë së hershme. Ky rekomandim jep

⁴ Britto, P., & Ravens., J., & Ponguta, L., (2011): Dora Dorës Universiteti “Yale” Qendra “Edward Zigler” për zhvillimin e fëmijës dhe politikave sociale., fq. 68

udhëzimet për krijimin e komisionit të tillë, për rolet dhe përgjegjësitë e tij, ashtu që ofrimi koheziv i shërbimeve të përforcohet nën udhëzimin e atij grupi.

Opsioni 3. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Opsioni i tretë shqyrton mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm të nivelit të edukimit parashkollor pa ndryshuar legjislacionin në nivel të ligjit. Përqendrimi sipas këtij opsioni, mund të jetë në ndryshimin e legjislacionit sekondar dhe masave tjera zbatuese.

Një gjë e tillë do të jep mundësinë që pjesërisht të përmirësojë gjendjen dhe të sanoj të metat e sistemit ekzistues brenda hapësirës që lejon ligji.

Në këtë rast, duhet të ndryshohen udhëzimet administrative (të cilat duhet ndryshuar edhe nëse vendoset për opsionin e dytë):

1. 13/2006-Zbatimi i Kurrikulës për edukim parashkollor (3-6 vjeç).
2. 9 /2007- Vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta.
3. 40/2007 - Mbikëqyrja profesionale pedagogjike e punës së edukatoreve dhe bashkëpunëtorëve profesional.
4. 41/2007-Zbritja e tarifave që duhet të paguhet nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore.
5. 42 / 2007 -Kushtet dhe mundësitë e përkrahjes së edukimit parashkollor nga komuniteti.
6. 43-/2007 -Përcaktimi i procedurës, rasteve dhe afateve të ndërprerjes së punës në institucione parashkollore.
7. 44 /2007 - Kohëzgjatja e programeve tjera parashkollore
8. 45/2007 -Publikimi (shpallja) i organizimit të edukimit në institucionet parashkollore.
9. 46/2007 -Mënyra e zgjedhjes së programeve parashkollore nga prindërit e fëmijëve.
10. 47/ 2007-Fondi javor i orëve për edukatore.
11. 48/ 2007 -Të dhënat e fëmijës aplikues dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave.
12. 1/2008-Këshilli drejtues, përbërja, kompetencat e tij dhe përbërja e komisionit, mënyra e zgjedhjes së udhëheqësve dhe personelit të institucioneve parashkollore.
13. 2/2008-Mjetet e dedikuara për financimin e edukimit parashkollor publik dhe mënyra e shpenzimit të tyre.
14. 6/2008-Përfshirja e fëmijëve në institucione parashkollore.
15. 9/2011-Për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave statistikore nga shkollat dhe institucionet parashkollore në arsimin parauniversitar duke përdorur sistemin për menaxhimin e informatave në arsim.
16. 15/2012-Përkujdesja për fëmijëri të hershme në arsim.
17. 19/2016 -Për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë.

Pasoja negative

1. Pasoja nga Opsioni 1 status quo- janë:

Mosndryshimi i qasjes dhe politikave për nivelin e edukimit parashkollor do të vazhdojë të ndikojë në vazhdimin e situatës jo të kënaqshme që tani kemi në këtë nivel. Kjo do të thotë që institucionet e

edukimit parashkollor, do të vazhdojnë të mos përfshijnë disa kategori të fëmijëve, do të vazhdohet me mungesë koordinimi mes institucioneve të ndërlidhura, sidomos paqartësi në kompetenca mes nivelit qendror dhe komunal, mungesë të mbikëqyrjes së zbatimit, ofrim jo cilësor të shërbimeve për fëmijët e nivelit parashkollor. Një situatë e tillë do të ketë pasoja në mënyrë jo të drejtpërdrejtë edhe në avancimin në procesin e integritit evropian të vendit.

2. Pasojat nga opsioni 2, ndryshimi i politikës ekzistuese është:

Opsioni i dytë është opsioni i rekomanduar dhe benefitet e zgjedhjes dhe zbatimit të tij janë të cekura më lartë. Megjithatë, edhe përzgjedhja e këtij opsioni dhe zbatimi i tij mund ketë efektet e veta sidomos në fazat e para të zbatimit. Prandaj, efektet apo pasojat e përzgjedhjes së tij mund të jenë:

1. Vetë procesi i hartimit, miratimit dhe fillimit të zbatimit të ligjit të ri, do të marrë kohë dhe shkakton vonesa në fillimin e një qasje së re dhe krijimin dhe riorganizimin e sistemit të ofrimit të shërbimeve edukative në nivel parashkollor.
2. Riorganizimi i sistemit si dhe zgjerimi i fushëveprimtarisë së ligjit, kategorive të veçanta të fëmijëve në sistem të shërbimeve, pastaj themelimi i strukturave koordinuese dhe ngritja e kapaciteteve në përgjithësi do të ketë një kosto më të lartë për buxhetin e shtetit.

1. Pasojat nga opsioni 3, ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Pasojat e opsioni të tretë janë të ndërlidhura me ato që janë të përmendura në opsionin e parë. Megjithatë, institucionet me ndryshimet në nivel të udhëzimeve administrative do të mundësojnë që pasojat të jenë më të vogla dhe të ketë mundësi për të ndryshuar gjendjen në një shkallë më të ulët sesa nëse zgjidhet opsioni i dytë psh. me ndryshime të vetëm udhëzimeve, nuk do të jetë e mundur të sigurohet gjithpërfshirja, riorganizimi i sistemit të ofrimit të shërbimeve si dhe ndërtimi i një sistemi koordinues duke marrë parasysh që përfshin një numër të madh të strukturave qeveritare dhe në nivel komunal do të ketë efektet e dobëta nëse nuk rregullohen me ligj.

Efekti shpërndarës

1. Me këtë politikë preken të gjithë fëmijët e të gjitha kategorive të popullsisë nga mosha 0 deri në 6 vjet. Ligji për Edukimin në fëmijërinë e hershme, prek sektorin publik (arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale etj) dhe sektorin privat, komunitetin e prindërve etj.
2. Ndikimet nuk kanë ndryshime respektivisht dallime në mes gjinive.
3. Ndërsa, efekti financiar është përcaktuar në Deklaratën Financiare të më lartshënuar.

Kapitulli 7

Konsultimi

Konsultimi i brendshëm

1. Konsultimi me ekspert/grupi punues si në vijim:

1. Kozeta Imami - eksperte në sektorin e edukimit - UNICEF, ka theksuar se ligji ekzistues ka nevojë të ndryshohet dhe se ligji i ri duhet t'i kontribuojë zhvillimit të fëmijëve në moshat e hershme në mënyrë që fëmijët të përgatiten për shkollë, gjithashtu ka diskutuar rreth rëndësisë që duhet t'i kushtohet në ligjin e ri për ushqimin e shëndetshëm të fëmijëve.
2. Hana Zylfiu, eksperte në fushën e edukimit parashkollor nga KEC (qendra për arsim e Kosovës), ka theksuar që mirëpret hartimin e ligjit të, ngase ligji aktual është shumë përshkruar i gjendjes, por i mungojnë disa elemente të cilat japin mundësi zhvillimi.
3. Sadifete Lumi - drejtoreshë e kopshtit, gjithashtu mirëpret hartimin e ligjit aktual sepse ligji aktual, ka qenë vështirë i implementueshëm në praktikën e përditshme në organizimin e punës edukative.
4. Diana Qarkaxhiu – drejtoreshë në DKA (drejtoria komunale për arsim)- Gjakovë, ka potencuar që në ligjin e ri duhet të paraqesim më shumë forma alternative të cilat mundësojnë përfshirjen më të madhe të fëmijëve në këtë nivel.
5. Lulavera Behluli - udhëheqëse e divizionit për arsim special në MASHT, gjithashtu është shprehur që ky ligj duhet të jetë shumë saktë i hartuar, ngase është njëri nga ligjet bazë i cili do të kontribuojë në të gjithë sistemin edukativo-arsimor. Gjithashtu, ka kërkuar që në ligj të saktësohet mirë aspekti i gjithpërfshirjes, konkretisht përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta.
6. Shkëmb Manaj - përfaqësuesi i prindërve, ka potencuar që me ndryshimin e ligjit ekzistues duhet të ketë kujdes të veçantë në programin e punës edukative/përdorimin e teksteve.
7. Fadile Dyla, drejtoreshë në departamentin e infrastrukturës- MASHT, ka potencuar gjithashtu nevojën që ky ligj të ndryshohet apo edhe të hartohet si i ri.
8. Mevlude Aliu, eksperte në fushën e edukimit parashkollor- IPK (Instituti Pedagogjik i Kosovës), ka përkrahur propozimndryshimin e ligjit për edukim parashkollor si dhe ka kërkuar që në ligjin e ri të saktësohet qartë dokumentacioni pedagogjik.
9. Mevlude Shamolli, zyrtare e lartë në MEF, ka kërkuar që ky ligj të jetë real, në mënyrë që të jetë lehtësim për shpenzime dhe të implementohet.
10. Nazife Azemi Latifi - edukatore, ka mirëpritur ligjin aktual si dhe ka kërkuar që në hartimin e ligjit të ri, vëmendje të veçantë t'i kushtojmë mënyrës së sigurimit të materialit didaktik.

2. Konkluzion i të gjithë ekspertëve ishte se kjo fushë duhet rregulluar, duhet të fuqizohet me ndryshimin e Ligjit ekzistues dhe duhet të zgjerohet fushëveprimtaria, sepse me akte të tjera nënligjore nuk mund të rregullohet ngase situata aktuale është e pafavorshme.

Diskutimi paraprak është mbajtur në pajtim me nenin 7 të Rregullores së Punës së Qeverisë, me grupin dhe akterët tjerë kompetent është mbajtur nga dt. 26.04.2016 deri më dt. 16.05.2016.

Konsultimi i jashtëm

Konsultimi i jashtëm është bërë me të gjitha institucionet dhe organet e organizatat me të cilat kemi pasur për obligim të konsultohemi nga dt. 26.04.2016 deri me dt. 21.02.2018

MF ka dhënë opinionin buxhetor për Deklaratën Financiare. SKQ, ka dhënë komentet e veta të cilat komente kanë qenë përmbajtësore dhe i kemi përfshirë në KD. MPAL ka dhënë komentin e vet se KD është në përputhje me legjislacionin vendor për pushtetin lokal.

Komente nga institucione tjera nuk ka pasur.

Kapitulli 8

Krahasimi i opsioneve

1. Nëse do të vendoset për opsionin për ruajtjen e statusit ekzistues, do të thotë që do të vazhdohet që sistemi i edukimit parashkollor të vazhdojë të funksionojë me ligjin ekzistues dhe aktet e tanishme nënligjore. Kjo sipas trendeve të zhvillimit të deritashëm nënkupton që situata të vazhdojë ashtu siç është deri më tani, shkalla e përfshirjes do të jetë e njëjtë, cilësia e shërbimeve në nivel të edukimit parashkollor nuk do të përmirësohet. Gjithashtu edhe zhvillimi i fëmijëve nuk do të shkojë drejt standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç dhe më e rëndësishmja nuk do të kemi fëmijë të përgatitur për shkollë dhe për jetë.
2. Opsioni i dytë nënkupton hartimin e ligjit të ri për edukimin në fëmijërinë e hershme, që do të thotë se ligji i ri do të adresoj një numër të të metave që janë aktualisht në kornizën ligjore që rregullon këtë fushë, dhe do të zgjeroj fushëveprimtarinë e tij, duke prekur edhe fëmijët jashtë institucioneve parashkollore. Kjo nënkupton përfshirje më të gjerë të fëmijëve në nivel parashkollor, do të krijohen mekanizmat efikas dhe efektiv për zhvillimin dhe avancimin, jo vetëm të sferës së edukimit, por do të kishte impakt edhe në zhvillimin e përgjithshëm të sistemit edukativo-arsimor dhe ekonomik në vend.
3. Nëse vendoset që ligji të mos ndryshohet, por ndryshimet të bëhen vetëm në nivel të akteve nënligjore dhe në masa zbatuese, atëherë ndryshimet do të jenë më të kufizuara në krahasim me opsionin e dytë. Në këtë rast, do të adresohen disa të meta që ekzistojnë në nivel të legjislacionit sekondar siç është specifikuar në kapitullin që flet për opsionin e tretë.

Kapitulli 9. Rekomandimi

1. Bazuar në këtë draftkonceptdokument (pas miratimit me Vendim nga Qeveria), rekomandon përfshirjen në agjendën legjislative hartimin e Projektligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, i cili gjithashtu pas hartimit nga ana e MASHT-it rekomandohet të miratohet gjatë vitit 2018 në qeveri dhe Kuvend.
2. Kostoja për zbatimin e këtij Ligji është përcaktuar në Deklaratën Financiare, e cila është mbuluar me opinionin e Ministrisë së Financave.

Kapitulli 10. Komunikimi

Hartimi i KD për edukimin në fëmijërinë e hershme, ju është dërguar për komunikim të gjitha palëve të interesit. Gjithashtu, për ndryshimet e sistemit të këtij nivelit të edukimit janë informuar dhe konsultuar të gjitha kategoritë e prekura nga ky ligj.

KD ka qene po ashtu ne Konsultim Publik dhe i publikuar në Platformën Qeveritare nga dt.28.03.2018 deri ne dt. 20.04.2018 dhe komentet e pranuar janë shqyrtuar dhe shumica prej tyre janë pranuar nga Grupi i ekspertëve për hartimin e KD.

Hartimi i projektligjit për edukimin në fëmijërinë e hershme, do t'ju komunikohet të gjitha palëve të interesit. Gjithashtu, për ndryshimet e sistemit të këtij nivelit të edukimit do të informohen dhe konsultohen të gjitha kategoritë e prekura nga ky ligj. Një plan komunikimi mund të hartohet, për të informuar palët e interesit me dispozitat e PL, efektet me të drejtat dhe obligimet që dalin nga zbatimi i politikave të reja.